

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe Gani Avdiu e Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.A. nga Prishtina, i punësuar tek e paditura, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës PTK sh.a., me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit dhe kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1526/12, të datës 11.06.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës PTK sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1526/12, i datës 11.06.2014, në pjesën me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit B.A. nga Prishtina dhe është anuluar aktvendimi i të paditurës nr.01-1040-923/2012, i datës 07.03.2012, **VËRTETOHET**.

II. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) sh.a, me seli në Prishtinë, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1526/12, i datës 11.06.2014, në pjesën e kërkesëpadiës me të cilën është detyruar e paditura që paditësit t’ia paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe të trustit në mes të gradës 9 dhe 7, për çdo muaj duke filluar nga data 01.02.2012, me kamatë 4%, e deri në pagesën definitive si dhe pjesa e kërkesëpadiës për shpenzime të procedurës dhe lënda për këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit B.A. nga Prishtina. Në pikën II të dispozitivit e ka anuluar aktvendimin e të paditurës Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës nr.01-1040-923/2012, i datës 07.03.2012, dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe të trustit në mes të gradës 9 dhe 7, për çdo muaj duke filluar nga data 01.02.2012, e tutje me kamatë 4%, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta hedhë si të pasafatshme, padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit B.A. ose ta aprovojë si të bazuar ankesën e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) sh.a, me seli në Prishtinë, ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1526/12, të datës 11.06.2014, ashtu që ta refuzojë si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit B.A. nga Prishtina, ose ta aprovojë si të bazuar ankesën e të paditurës dhe ta prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1526/12, të datës 11.06.2014 dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës, është pjesërisht e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 06.06.2012, në gjykatën e shkallës së parë paditësi ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të anulimit të vendimit dhe kompensimit të pagës, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1526/12, të datës 11.06.2014, me të cilën e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimimit, gjykata ka arsyetuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi sipas kontratës së punës ishte caktuar të e paditura në vendin e punës zyrtar i llogarive për korporata, me pagesë mujore sipas gradës 9, nuk ishte kontestuese se me aktvendimin e të paditurës nr.01-1040-923/2012, i datës 07.03.2012, paditësit i janë caktuar të ardhura personale sipas gradës 7, e as nuk ishte kontestuese fakti se kundër aktvendimit në fjalë paditësi kishte parashtruar ankesë në Komisionin e ankesave të PTK-së. Gjykata e shkallës së parë theksoi se kontestuese ishte ligjshmëria e vendimit të kryeshefit ekzekutiv të të paditurës nr.01-1040-923/2012, i datës 07.03.2012, me të cilin vendim paditësit i caktohen të ardhura nga grada 7, përkundër faktit se me kontratë ishte paraparë që paditësi të paguhet sipas gradës 9. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë ulja e lartësisë së pagës së paditësit në gradën 7, nuk ka bazë ligjore. Nga provat e shqyrtuara ka rezultuar se paditësi dhe e paditura në kontratë janë pajtuar për lartësinë e pagës mujore të paditësit nga grada 9, prandaj nga ky fakt dhe në mbështetje të nenit 55 të Ligjit të Punës, gjykata e shkallës së parë vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Vendimin mbi shpenzimet e ka nxjerrë në mbështetje të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe në rregulloren për unifikimin e taksave gjyqësore, ashtu që paditësit i është njohur e drejta për kompensim në shumë prej 15 €, në emër të taksës gjyqësore në padi dhe në shumën

prej 15 €, në taksën për aktgjykim edhe pse në dispozitiv të aktgjykimit gjykata ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është vërtetuar (pika I e këtij aktgjykimi) është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar drejtë të drejtën materiale në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sipas kontratës së punës, paga është përcaktuar sipas gradës 8 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit. Kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të paditurës, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të të paditurës për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit pasi që në rekomandimin e Ministrisë, ngase nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, për çfarë arsye pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave, prandaj nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menaxhues. Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale përkatësisht dispozitën e nenit 55 paragrafi 1, të Ligjit të Punës me të cilën është përcaktuar se *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*.

Në këtë rast se punëdhënësi dhe punëmarrësi me kontratë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë kanë përcaktuar përveç tjerave edhe lartësinë e pagës e cila duhet të përmbushet nga punëdhënësi.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, ngase sipas të paditurës dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit, është pretendim i pathemeltë. Aktgjykimi i atakuar është mjaft i qartë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe të arsyetimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka

dhënë arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore.

Gjykata e vlerësoi të pabazuar pretendimin ankimor të paditurës lidhur me afatshmërinë e padisë për shkak se, në bazë të nenit 87 të Ligjit të punës, “Ligji nr. 03/L-212 të dt. 01.11.2010” saktësisht parashihet se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3- vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës dhe duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, kjo gjykatë vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar të drejtën materiale. Po ashtu edhe në bazë të nenit 372 të LMD, i cili ishte në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit për uljen e gradës, saktësisht është përcaktuar se kërkesat periodike parashkruhen 3-vjet, nga rrjedha e secilës dhënie të veçantë për pagesë, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të këtyre ligjeve rrjedh se drejtë është aplikuar e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike.

Në anën tjetër, aktgjykimi i gjykatës shkallës së parë në pjesën që është prishë dhe është kthyer në rishqyrtim sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë e rrjedhimisht dispozitivi është në kundërshtim me arsyet e dhëna. Dispozitivi është i paqartë sepse nuk është përcaktuar lartësia e ndryshimit të pagës, ndryshimit të bonusit dhe trustit në mes të gradës 8 dhe 7, e cila duhet të paguhet nga e paditura, ndërsa është në kundërtënie me arsyet sepse kjo pjesë e kërkesëpadisë nuk është arsyetuar përkatësisht nuk janë paraqitur arsye për faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që gjykata të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Për pjesën e kthyer në rigjykim udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedure të vërtetojë se a është kontestuese në mes të palëve ndërgjyqësore lartësia e kërkesëpadisë dhe varësisht nga deklarimi i palëve për kontestueshmërinë e lartësisë së kërkesëpadisë, e sipas nevojës lartësinë e kërkesëpadisë ta vërtetoj me ekspertizë ashtu që pas administrimit dhe vlerësimit edhe të provave tjera të vendos në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Në lidhje me vendimin për shpenzimet gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për arsye se vendimi i gjykatës së shkallës së parë në këtë pjesë është kontradikor dhe në kundërshtim me arsyet e aktgjykimit, në ndërkohë që shpenzimet duhet të përcaktohen në mënyrë unike për të gjitha shpenzimet e pranueshme në përfundim të vendosjes meritore për të gjitha kërkesat.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe pika (c) e LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4315/14, me datën 27.07.2018

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj**